

## **RREGULLORE E BRENDSHME PËR PAGESËN E SHKOLLIMIT**

### **DISPOZITATE PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 - Qëllimi**

Biznesi “Gjimnazi Britanik për Teknologji SH. P. K.” është themeluar si biznes me përgjegjësi të kufizuara në përputhje me dispozitat e statutit të biznesit. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i çështjes së pagesës për shkollim. Kjo rregullore është bazuar në kontratën për regjistrim, e nënshkruar nga dy palët (prind-institucion)

#### **Neni 2 - Fushëveprimi**

2.1 Kjo rregullore për pagesën rregullon çështjen e pagesës së prindërve për shkollimin e fëmijëve të tyre. Ajo merr parasysh kushtet e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

2.2 Përmes kësaj rregullore, nxënësit dhe prindërit do të kuptojnë kohën kur bëhet pagesa nepër këste.

2.3 Rregullorja e pageses së shkollës është e detyrueshme për të gjithë prindërit. Cilido, sipas detyrës dhe kompetencave të veta, duhet të ndihmojnë që rregullat të zbatohen me ndershmëri dhe rigorozitet.

#### **Neni 3 – Dërgesa e profatures**

3.1 Çdo muaj prindërve do t’u dërgohet profatura për pagesë të kështit. Dërgesa e profaturës bëhet çdo herë me datë 25 të muajit paraprak.

3.2 Dërgesa e profatures bëhet përmes SMS në telefon, në e-shkollori dhe poashtu me e-mail.

3.3 Profatura bëhet vetëm për një këstë të çdo muaji

#### **Neni 4 – Paralajmërimi për mospagesë**

4.1 Paralajmërimi për mospagesë bëhet pasi që vërtetohet se nuk është bërë pagesa për muajin aktual, edhe pas dërgesës së profatures sipas nenit 3 të kësaj rregullore.

4.2 Paralajmërimi për mospagesë bëhet përmes SMS në telefon, në e-shkollorin dhe poashtu me e-mail.

4.3 Paralajmërimi për mospagesë bëhet çdo here me datë 6 të muajit aktual.

#### **Neni 5 – Paralajmërimi për ndërprerjen e sistemeve**

5.1 Paralajmërimi për ndërprerjen e sistemit Microsoft dhe e-Shkollori bëhet pasi që është vërtetuar se nuk është bërë pagesa deri me datë 14 të muajit aktual.

5.2 Paralajmërimi për ndërprerjen e sistemit Microsoft dhe e-Shkollori bëhet përmes SMS, e-mailit, si dhe përmes e-shkollorit.

5.3 1 Paralajmërimi për ndërprerjen e sistemit Microsoft dhe e-Shkollori bëhet çdo herë me datë 15 të muajit aktual

#### **Neni 6 – Kontakti përmes telefonit dhe ndërprerja e sistemeve**

6.1 Pas vërtetimit se nuk është kryer pagesa edhe pas paralajmërimeve në nenin 4 dhe 5, atëher me datë 20 të muajit aktual personi kontaktohet përmes telefonit.

6.2 Nëse edhe pika 6.1 nuk funksionon atëher bëhet ndërprerja e sistemeve të Microsoft dhe e-shkollorit, me datë 22 të muajit aktual

### **Neni 7 – Procedimi i lëndes**

7.1 Nëse i njeiti nuk e ka kryer pagesen edhe pas paralajmërimeve të cekura në nenin 4,5 dhe nenit 6, atëher bëhet procedimi i lëndes tek përmbaruesi si kontest kontraktual. Per te gjithë vitin

7.2 Njoftimi se lënda është proceduar tek organet kompetente bëhet përmes SMS në telefon, e-shkollorit dhe e-mailit. Njoftimi bëhet me datë 1 të muajit vijues.

### **Neni 8 – Shkëputja e kontrates**

8.1 Pasi që janë shterur të gjitha munësitë dhe mjetet me të cilat është kërkuar të përmbushet obligimi financiar dhe pasi që kanë kaluar të gjitha afatet, shkolla ka të drejtë që ta shkëputë kontraten me prindin e nxënësit për arsye financiare.

8.2 Shkëputja e kontrates bëhet pasi që është dërguar lënda tek përmbaruesi.

### **Neni 9 – Hyrja në fuqi e rregullores**

Kjo rregullore hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga drejtori ekzekutiv

Drejtori i shkollës:

Muzafer Shala

---

Prishtinë: 08.08.2022

